



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA**

DEGA E FINANCËS

**Dokumentat e nevojshme për përfitimin e bursave për vitin
akademik 2018-2019**

Në zbatim të V.K.M-së Nr. 903 datë 21.12.2016, për përfitimin e bursave, njoftojmë se aplikimi për t'u trajtuar me bursë do të bëhet **nga data 01 nëntor 2018 deri më 23 nëntor 2018, personalisht** nga studenti pranë zyrës së Financës:

Sipas V.K.M-së Nr. 903 datë 21.12.2017, pika

5. Studente në nevojë konsiderohen:

5.1 Sipas kriterit ekonomik

a) Studentët që ndjekin studimet në largësi mbi 10 (dhjetë) km nga vendbanimi i përhershëm i tyre, familjet e të cilëve trajtohen me ndihme ekonomike nga njesia e vetëqeverisjes vendore.

Për këtë kategori dokumentat që duhet të plotësohen janë:

1. Kërkesë për t'u trajtuar me bursë të përgatitur nga vetë studenti.
2. Vërtetim studenti.
3. Deklaratë personale që plotësohet nga kryefamiljari (merret pranë zyrës së informacionit).
4. Çertifikatë familjare.
5. Vërtetimin banor i lagjes.
6. **Vërtetim i trajtimit me ndihmë ekonomike** nga seksioni i ndihmës ekonomike në Bashki, ku të cilësohet nr. i dosjes dhe vlera e saj. Ky dokument duhet të jetë i protokolluar, me dy firma dhe me vulë.
7. Vërtetim nga Shërbimi Kombëtar i Punësimit për prindërit dhe pjestarët e tjerë të familjes që nuk ndjekin studimet (të regjistruar si kërkues për punë).
8. Vërtetim familjarisht nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, nëse pjestarët e familjes trajtohen me pension (ku të specifikohet shuma e pensionit nëq përfiton, si dhe çfarë pensioni përfitohet pleqërie apo invaliditeti). Nëse jo vërtetim negative.
9. Vërtetim nga Drejtoria e Përgjithshme Rajonale e Tatimeve që nuk ushtron biznes privat për çdo pjestar të familjes mbi 18 vjeç (përfshirë edhe vetë studentin).
10. Vërtetim nga Zyra e Tatim Taksave në Bashki që nuk ka të regjistruar aktivitet privat fitimprurës për çdo pjestar të familjes mbi 18 vjeç (përfshirë edhe vetë studentin).



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA

11. Vërtetim pasurie nga Zyra e Regjistrimit të Pasurive të paluajtshme për të gjithë pjestarët e familjes mbi moshën 18 vjeç. N.q.se familja zotëron pronë apo truall dhe të ardhurat që sigurojnë prej saj.
12. Për motra apo vëllezër student në Universitet, vërtetimin e tyre si studente dhe nëse trajtohen me bursë.
13. Fotokopje të kartës së ID të vetë studentit.

b) Secili nga studentet, i cili rezulton bashkëshort me fëmijë, dhe kur familja e tij trajtohet me ndihme ekonomike nga njesia e vetëqeverisjes vendore;

Për këtë kategori dokumentat që duhet të plotësohen janë:

1. Kërkesë për t'u trajtuar me bursë të përgatitur nga vetë studentit.
2. Vërtetim studentit.
3. Deklaratë personale që plotësohet nga kryefamiljari (merret pranë zyrës së informacionit).
4. Çertifikatë familjare.
5. Vërtetim konvikti për bashkëshortët me fëmijë.
6. **Vërtetim i trajtimit me ndihmë ekonomike** nga seksioni i ndihmës ekonomike në Bashki, ku të cilësohet nr. i dosjes dhe vlera e saj. Ky dokument duhet të jetë i protokolluar, me dy firma dhe me vulë.
7. Vërtetim familjarisht nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, nëse pjestarët e familjes trajtohen me pension. Nëse jo vërtetim negative.
8. Vërtetim nga Drejtoria e Përgjithshme Rajonale e Tatimeve që nuk ushtron biznes privat për bashkëshortin/en (përfshirë edhe vetë studentin).
9. Vërtetim nga Zyra e Tatim Taksave në Bashki që nuk ka të regjistruar aktivitet privat fitimprurës për bashkëshortin/en (përfshirë edhe vetë studentin).
10. Vërtetim pasurie nga Zyra e Regjistrimit të Pasurive të paluajtshme për bashkëshortin/en (përfshirë edhe vetë studentin). N.q.se familja zotëron pronë apo truall dhe të ardhurat që sigurojnë prej saj.
11. Fotokopje të kartës së ID të vetë studentit.

c) Personat me aftësi të kufizuar, të vërtetuar nga Komisioni Mjekësor i Caktimit të Aftësive për punë, përfitues të pagesës së aftësisë së kufizuar.

Për këtë kategori dokumentat që duhet të plotësohen janë:

1. Kërkesë për t'u trajtuar me bursë të përgatitur nga vetë studentit.
2. Vërtetim studentit.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA

3. Deklaratë personale që plotësohet nga kryefamiljari (merret pranë zyrës së informacionit).
4. Çertifikatë familjare.
5. Fotokopje të kartës së ID të vetë studentit.
6. Raportin Mjeko Ligjor nga KMCAP-i (i fotokopjuar dhe i noterizuar).
7. Vërtetim nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore apo nga zyrat e ndihmes ekonomike në Bashki për pagesën e aftësisë së kufizuar.
8. Vërtetimin nga Shoqata përkatëse e Invalidëve.
9. Librezë Invaliditeti e fotokopjuar por me vulë të njomë të shoqatës.
10. **A)** Nqse familja trajtohet me ndihme ekonomike, student duhet të paraqesë **Vërtetim i trajtimit me ndihmë ekonomike** nga seksioni i ndihmës ekonomike në Bashki, ku të cilësohet nr. i dosjes dhe vlera e saj. Ky dokument duhet të jetë i protokolluar, me dy firma dhe me vulë.
11. **B)** Nqse familja nuk trajtohet me ndihme ekonomike, student duhet të paraqesë Vërtetimin e të ardhurave për çdo pjestar të familjes mbi 18 vjeç që janë në marrdhënie pune.
12. Vërtetim nga Shërbimi Kombëtar i Punësimit për prindërit dhe pjestarët e tjerë të familjes që nuk ndjekin studimet (të regjistruar si kërkues për punë).
13. Vërtetim familjarisht nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, nëse pjestarët e familjes trajtohen me pension (ku të specifikohet shuma e pensionit nqs përfiton, si dhe çfarë pensioni përfitohet pleqërie apo invaliditeti). Nëse jo vërtetim negative.
14. Vërtetim nga Drejtoria e Përgjithshme Rajonale e Tatimeve që nuk ushtron biznes privat për çdo pjestar të familjes mbi 18 vjeç (përfshirë edhe vetë studentin).
15. Vërtetim nga Zyra e Tatim Taksave në Bashki që nuk ka të regjistruar aktivitet privat fitimprurës për çdo pjestar të familjes mbi 18 vjeç (përfshirë edhe vetë studentin).
16. Vërtetim pasurie nga Zyra e Regjistrimit të Pasurive të paluajtshme për të gjithë pjestarët e familjes mbi moshën 18 vjeç. N.q.se familja zotëron pronë apo truall dhe të ardhurat që sigurojnë prej saj.
17. Për motra apo vëllezër student në Universitet, vërtetimin e tyre si studente dhe nëse trajtohen me bursë.
18. Fotokopje të kartës së ID të vetë studentit.

5.2 Jashtë kriterit ekonomik:

1. Studentët që kanë përfunduar vitet pararendëse më të gjitha notat 10-ta dhe kanë shlyer të gjitha detyrimet e parashikuara.

Për këtë kategori dokumentat që duhet të plotësohen janë:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA

- a. Vertetim Studenti
 - b. Deklaratë personale që plotësohet nga kryefamiljari (merret pranë zyrës së informacionit).
 - c. Fotokopje të kartës së ID të vetë studentit.
2. Studentët që kanë përfutur statusin e jetimit.
- a. Vertetim Studenti
 - b. Deklaratë personale (merret pranë zyrës së informacionit).
 - c. Fotokopje të kartës së ID të vetë studentit.
 - d. Çertifikat familjare
 - e. Fotokopje të noterizuar të statusit të jetimit.
3. Studentët që kanë humbur përgjegjësinë prindërore, me vendim gjykatë të formës së prerë.
- a. Vertetim Studenti
 - b. Deklaratë personale (merret pranë zyrës së informacionit).
 - c. Fotokopje të kartës së ID të vetë studentit.
 - d. Çertifikat familjare.
 - e. Vendimin e gjykatës të formës së prerë.
4. Studentët që janë identifikuar e trajtuar si viktimat të trafikut të qenieve njerëzore dhe kanë humbur kujdesin prindëror.
- a. Vertetim Studenti
 - b. Deklaratë personale (merret pranë zyrës së informacionit).
 - c. Fotokopje të kartës së ID të vetë studentit.
 - d. Çertifikat familjare
 - e. Vendimin e gjykatës të formës së prerë për identifikimin dhe faktin që janë trajtuar si viktimat të trafikut të qenieve njerëzore dhe kanë humbur kujdesin prindëror.
5. Studentet që rezultojnë fëmijë të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ Shtetëror dhe të Policisë së Burgjeve që kanë humbur jetën në krye dhe për shkak të detyres.
- a. Vertetim Studenti
 - b. Deklaratë personale (merret pranë zyrës së informacionit).
 - c. Fotokopje të kartës së ID të vetë studentit.
 - d. Çertifikat familjare.
 - e. Vërtetimin nga Ministria përkatëse (fotokopje e noterizuar).



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA**

5.3 Studentët nuk përfitojnë bursë apo humbasin të drejtën e perfitimit ne rast se:

1. Janë ndarë nga trangu familjar.
2. Familjet e tyre ushtrojnë veprimtari private.
3. Vazhdojnë studimet në një program të dytë studimi.
4. Shpallen ngelës dhe humbasin vitin shokllor për arsye të rezultateve jokaluase.
5. Nuk kanë përfunduar programin e studimit brenda kohëzgjatjes normale të tij, të përcaktuar në aktin e hapjes së programit përkthës të studimit.

AFATI PËR DORËZIMIN E DOKUMENTACIONIT NGA 01.11.2018 deri në 23.11.2018.

Dokumentacioni dorëzohet personalisht nga secili prej studentëve.

Pas dorëzimit të dokumentacionit, vendimi për studentët që do të përfitojnë bursë do të merret nga Bordi i Administrimit.